



Janar 2017

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shkurt

Mars

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Janar 2017

© Ministria e Financave, 2017

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: eva.doda@financa.gov.al
vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin janar 2017 arriti në 103.75 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin janar 2017 ishte 2.8 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin janar 2017 ishte 128.40 lekë për dollarë dhe 136.57 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit janar 2017 shënuan kuotën 0.69 për qind për ato 12 –muajore; 0.57 për qind për depozitat 6-mujore; 0.31 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.86 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 6.27 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.74 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,260,274 milionë lekë në muajin janar, duke shënuar një rritje prej rreth 4 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e tretë të 2016-ës shënoi rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 56.1 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar 2017 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 7.8 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 2.9 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 4.9 miliona lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar 2017, arritën në rreth 32.8 miliardë lekë ose afërsisht 105 për qind e planit për këtë periudhë.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 25.02 miliardë lekë ose 95 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin janar 2017 ishte 2.8%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 1.5%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin janar 2017 shënoi rritje prej 1.5 për qind krahasuar me muajin paraardhës. Ky indeks ka shënuar gjithashtu rritje edhe për muajt dhjetor dhe nëntor 2016 me përkatësisht 0.9 dhe 0.1 për qind në krahasim me muajt parardhës përkatës. Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin janar 2016 shënoi rritje prej 0.9 për qind në krahasim me muajin paraardhës. Ndërsa në muajt dhjetor dhe nëntor 2015, indeksi i çmimeve të konsumit shënoi përkatësisht rritje me 0.6 për qind dhe rënie me 0.3 për qind në krahasim me muajt paraardhës përkatës.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +5.8%, duke kontribuar me +2.33 pikë përqindje; “Argëtim dhe kulturë” me një rritje vjetore të çmimit prej +3.1%, duke kontribuar me +0.08 pikë; “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me një rritje vjetore të çmimit prej +0.15%, duke kontribuar me +0.16 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.8%.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupi që pati kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm ishte “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë ” me një rënie vjetore të çmimit prej -0.1%, duke mos ndikuar në inflacionin e përgjithshëm prej +2.8%

Ndryshimi mujor i indeksit është 1.5%. Krahasuar me muajin dhjetor 2016 rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me 3.7%. Ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Veshje dhe këpucë” me -1.0%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2016	1.5	0.2	0.3	0.3	0.7	1.2	1.9	2.0	1.8	1.5	1.9	2.2
2017	2.8											

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin janar 2017, arriti në 136.57 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.83 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit janar, një euro u këmbye me 136.39 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin janar 2017 arriti në 128.40 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 0.09 për qind kundrejt muajit dhjetor 2016. Në fund të muajit janar, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 127.37 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin janar të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 1.29 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 0.81 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës evropiane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.94 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave


Gjatë muajit janar 2017, normat e interesit të depozitave me afat 1-mujor shënuan nivelin më të lartë prej 0.86 për qind, pasuar nga ato me afat 12-mujore që arritën kuotën 0.69 për qind. Normat e interesit të depozitave me afat 3 dhe 6-mujore shënuan përkatësisht kuotat 0.31 dhe 0.57 për qind. Të gjitha normat e interesit të depozitave në lekë kanë shënuar rënie në krahasim me muajin e mëparshëm dhe rënia më e madhe prej 0.21 pikë përqindje vihet re tek normat e interesit me afat maturimi 6-mujor.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1-mujore. Rënia më e madhe prej 0.49 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 12-mujor, pasuar nga depozitat me afat të maturimit 6-mujor me rënie vjetore prej 0.39 pikë përqindje.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit janar 2017 shënoi rritje me 1.73 pikë përqindje krahasuar me muajin dhjetor 2016, duke arritur në nivelin 6.27 për qind. Norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi gjithashtu rritje me 2.73 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë duke arritur nivelin 9.74 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit janar 2017, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 3.2 dhe 2.25 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rritje mujore të këtyre *yield*-ve të bonove të thesarit me 0.28 dhe 0.25 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Ndërsa për bonot 1-mujore norma e interesit ishte 1.22 pikë përqindje duke shënuar kështu dhe rritjen mujore më të madhe.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë



4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të vitit 2016 shënoi rënie të mjeteve valutore, me rreth 56 milionë euro. Tremujori i tretë i 2016-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 208 milionë euro, rreth 34 për qind më i ulët referuar të njëjtës periudhë në një vit më parë. Në krahasim me një vit më parë, deficitin e tregtisë së mallrave u thellua me tej me 10% duke arritur në 680 milionë euro. Flukset e kapitalit, shuma e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 12.7 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 2,647 milionë euro dhe janë zgjeruar me 10% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 208 milionë euro, rreth 34% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i deficitit korrent i atribuohet rritjes së pozicionit suficit në tregtinë e shërbimeve (me 129 milionë euro) dhe në të ardhurat parësore dhe dytësore (me 40 milionë euro). Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për vitin 2016:


- (i) bilanci tregtar me -680.0 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 269.1 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -6.5 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 209.8 milionë euro.

Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit janar 2017, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 83,991 milionë lekë krahasuar me muajin janar të vitit 2016. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 76,473 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 7,518 milionë lekë.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,260,274 milionë lekë në muajin janar 2017, duke shënuar rritje prej rreth 48,509 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 4 për qind. Në muajin janar 2017, sistemi bankar rezulton me një rënie prej 3,179.8 milionë lekë në mjetet valutore neto krahasuar me muajin dhjetor 2016.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin janar 2017 arriti në rreth 545,233 milionë lekë. Teprica e kredisë, krahasuar me muajin dhjetor 2016 shënoi rritje me vlerë 2,019.6 milionë lekë, pra rritje prej rreth 0.37 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 52.6 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 286,531 milionë lekë.

Gjatë muajit janar 2017, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 62.4 për qind ose 340,254 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 31 për qind ose 168,147 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.93 dhe 1.67 për qind apo 26,880 dhe 9,114 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin janar 2017, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 50.63 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 38.27 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.04 për qind dhe rreth 24.13 për qind.



7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin janar 2017 shënoi rënie me 0.18 për qind krahasuar me muajin paraardhës dhjetor 2016. Kjo ofertë arriti në rreth 246,377 milionë lekë në fund të muajit janar 2017, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin janar 2016 prej 0.95 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin janar 2017, kanë pësuar rënie prej 4,312 milionë lekë në krahasim me muajin janar 2016. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 85.2 për qind të tyre.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Ndërsa depozitat në valutë gjatë muajit janar 2017 shënuan rritje prej 31,842 milionë lekë, mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 81.8 për qind të depozitave në valutë.

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit janar 2017, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 85.2 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 10.8 për qind dhe nga “Korporata të tjera financiare” me 2.0 për qind.

“Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 81.8 për qind dhe rreth 16.1 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 83.4 për qind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 845,960 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (137,420 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (15,370 milionë lekë) dhe “Korporata jofinanciare publike” (13,106 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 2,042 milionë lekë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit janar 2017, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën 1,013,898 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 300 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 27,530 milionë lekë.




Fig-13

Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë




Fig-14

Përberja e depozitave Janar 2017

Burimi: Banka e Shqipërisë


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për muajin janar 2017 janë mbledhur rreth 32.8 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 25.02 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 24.03 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 1.2 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 9.5% janë financime të brendshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 22.02 miliardë lekë (ose rreth 108% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 0.9 miliardë lekë (ose rreth 104% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 7.8 miliardë lekë (ose rreth 107% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 1.7 miliardë lekë (ose rreth 90% e planit të periudhës janar 2017).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 24.0 miliardë lekë, 5.4 miliardë lekë (22.5% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 2.8 miliardë lekë (11.6%) për interesat, 1.5 miliardë lekë (6.2%) për shpenzime operative dhe



mirëmbajtje, 55 milionë lekë (0.2%) për subvencione, 11.2 miliardë lekë (46.6%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1.7 miliardë lekë (7%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 1.0 miliardë lekë (4%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 7% (shpenzime personeli), 7% (shpenzime për interesat), 4% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 2% (subvencione), 7% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 4% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 4% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 0.3%, ndërsa financimi i huaj është 4% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar 2017 ishin rreth 32.8 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 30.9 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 1.7 miliardë lekë.

Tab - 2

*Të ardhurat gjatë periudhës Janar 2017 (mld Lekë)
Revenues during January 2017 (in billion ALL)*

Burimi (Source)	Janar '17 January '17	Janar '16 January '16	Ndrysh(%) Chang (%)
TVSH (VAT)	10.1	10.0	1.7
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	1.6	1.4	9.7
Taksa doganore (Custom Tax)	0.4	0.39	4.0
Taksat nacionale (National Tax)	3.6	2.9	26.4
Akcizat (Excise)	2.7	2.7	-2.2
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	3.1	3.2	-3.3

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Janar – 2017;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: January – 2017;

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 7.8 miliardë lekë gjatë periudhës Janar 2017, u përdor kryesisht për pagesën e maturimit të huamarrjes së brendshme (rreth - 8.3 miliardë lekë) dhe për huanë afatgjatë të huaj (rreth 0.5 miliardë lekë).

Për muajin janar 2017, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 32.894 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 25.028 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin janar 2017, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 32.8 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 24.0 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 1.2 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017	
Janar	0.7	1.0	0.8	1.4	0.9	1.5	0.7	1.00	0.8	1.4	0.9	0.9	1.6	2.7	1.7	1.3	1.5	2.8	January
Shkurt	1.3	1.1	1.4	2.4	1.1		1.0	1.05	1.1	1.9	1.0		0.6	2.5	1.9	2.3	0.2		February
Mars	0.4	0.2	0.5	0.4	0.5		0.8	0.77	0.9	1.4	0.8		1.0	2.4	2.2	2.2	0.3		March
Prill	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	-0.4		0.6	0.55	0.5	0.9	0.5		1.6	2.3	1.7	2.3	0.3		April
Maj	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	-1.2		0.3	0.24	0.2	0.4	0.2		1.9	2.1	1.6	1.8	0.7		May
Qershor	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	-0.6		0.1	0.15	0.1	0.1	0.04		2.2	2.3	1.5	1.4	1.2		June
Korrik	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7	0.05		0.1	-0.03	0.0	0.2	0.32		2.7	1.6	1.8	1.3	1.9		July
Gusht	0.4	-0.1	0.1	0.8	0.86		0.1	-0.04	0.0	0.1	0.31		2.8	1.2	2.0	1.9	2.0		August
Shtator	0.2	0.8	0.3	0.6	0.40		0.1	0.06	0.0	0.2	0.17		2.6	1.7	1.5	2.2	1.8		September
Tetor	0.2	0.1	0.1	0.01	-0.2		0.1	0.05	0.0	0.2	0.13		2.4	1.7	1.4	2.1	1.5		October
Nëntor	0.2	-0.5	-0.2	-0.3	0.1		0.1	0.01	0.0	0.1	0.12		2.5	1.0	1.7	2.1	1.9		November
Dhjetor	0.9	1.7	0.7	0.6	0.9		0.2	0.15	0.1	0.17	0.19		2.4	1.9	0.7	2.0	2.2		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2013	2014	2015	2016	2017	Currency
					Janar January	
<i>Mesatarja e periudhës</i>						<i>Average of period</i>
USD	105.67	113.64	126.64	128.29	128.40	USD
EURO	140.27	140.11	137.65	135.27	136.57	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>						<i>In the end of period</i>
USD	101.86	115.23	125.79	128.17	127.37	USD
EURO	140.20	140.14	137.28	135.23	136.39	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2013	2014	2015	2016	2017	
Në përqindje					Janar	In percent
					January	
Norma e depozitave						Deposits rates
12-M	4.17	1.51	1.27	0.78	0.69	12-M
6-M	3.40	1.16	1.17	0.78	0.57	6-M
3-M	2.72	0.83	0.54	0.27	0.31	3-M
1-M	2.79	1.47	0.88	0.87	0.86	1-M
Norma e huasë						Lending rates
12-M	9.52	7.00	7.47	4.54	6.27	12-M
6-M	9.59	8.18	8.35	7.01	9.74	6-M
Norma e letrave me vlerë						Securities rates
Bono thesari 1/						Treasury bills 1/
3-M	3.40	3.15	-	-	1.22	3-M
6-M	3.54	3.16	2.46	2.00	2.25	6-M
12-M	3.66	3.33	2.40	2.92	3.20	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2017

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ê R T I M I	Janar January	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	32,894	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	186	Grants
II.	Të ardhura tatimore	30,935	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	22,022	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,146	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,620	Profit Tax
3	Akcizat	2,727	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,185	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,930	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	414	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	907	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	710	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	8,006	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	6,743	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,146	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,773	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë		Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,320	Income of budgetary institutions
	TOTALI I SHPENZIMEVE	25,028	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	24,032	Current Expenditures
I.1	Personeli	5,476	Personnel expenditures
1	Paga	4,700	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	776	Social insurance contributions
I.2	Interesat	2,830	Interest
1	Të Brendshme	2,078	Domestic
2	Të Huaja	752	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,567	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	55	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	11,285	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	8,645	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,640	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	1,788	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,031	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	41	Unemployment insurance benefits
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca		Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	1,239	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	118	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,121	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara		Arrears
V.	DEFICITI	7,866	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-7,866	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-8,394	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	4	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	7,474	Domestic new borrowing (net)
V.3	I huaj	528	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,473	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua	391	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-312	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-811	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	178	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

Tab - 5

Tabela e investimeve 2017

Table of investments 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Janar		
January		
Financim i brendshëm	118	Domestic financing
<i>Në %</i>	9.52	<i>In %</i>
Financim i huaj	1,121	Foreign financing
<i>Në %</i>	90.48	<i>In %</i>
Totali	1,239	Total
<i>Në %</i>	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2017
CUSTOMS REVENUES 2017**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar	
	January	
Taksë doganore	414	Customs Duties
TVSH	5,775	V.A.T
Akciçë	2,727	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	250	Others (Mineral Rent)
TOTALI	9,166	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2017 (TAX REVENUE)

TVSH	4,370	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,620	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,185	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,680	National taxes
TOTALI	12,855	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	22,021	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2017

The Deficit and Its Financing for 2017

*Të dhëna progresive (Progressive Data)**Në milionë lekë (In million Leks)*

	Janar January	
TË ARDHURAT	32,894	REVENUE
SHPENZIMET	25,028	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	7,866	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-7,866	FINANCING
Financimi i brendshëm	-8,394	Domestic
a. Bono Thesari Neto	358	Treasury bills
b. Obligacione	7,127	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	-7,006	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-7,611	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	605	Deposit of Social & Health Ins.
Mjete në ruajtje	11	Non-budget revenues
Të ardhura nga privatizimi	4	Privatization receipts
Të tjera detyrime (të përkohshme)	-105	Others
Huamarrje Brendshme Vendori	-10	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	528	Foreing
a. Hua afatgjatë	1,473	Long-term foreign borrowing (gross)
b. <i>Ndryshimi I gjëndjes së arkës</i>	-312	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-811	Repayments
Mbeshitetje Buxhetore	178	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	3M_I 2014	3M_II 2014	3M_III 2014	3M_IV 2014	Viti 2014	3M_I 2015	3M_II 2015	3M_III 2015	3M_IV 2015	3M_I 2016	3M_II 2016	3M_III_2016	
Llogaria korente	-1,026.70	-271.50	-341.00	-313.20	-377.50	-1,303.20	-261.60	-174.40	-327.10	-397.40	-224.20	-353.90	-207.60	Current Account.
Bilanci tregtar	-1,729.30	-426.20	-511.40	-560.70	-638.30	-2,136.60	-488.90	-488.50	-616.00	-705.40	-579.30	-677.00	-679.90	Trade Balance.
Eksporti i mallrave fob	1,731.50	212.40	264.90	228.80	219.20	925.30	172.00	250.50	177.20	171.40	125.50	194.30	172.80	Merchandise Exports. Fob
Importi i mallrave fob	-3,460.80	-638.60	-776.30	-789.50	-857.50	-3,061.90	-660.90	-739.00	-793.20	-876.80	-704.80	-871.30	-852.70	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	8.90	30.00	38.10	97.90	102.40	268.40	94.00	127.90	139.70	141.20	176.00	121.80	269.00	Services Balance.
Shërbimet Kredi	1,655.00	396.40	487.10	610.00	538.00	2,031.50	421.50	455.40	607.90	543.40	483.00	522.50	754.10	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	366.40	449.00	512.10	435.60	1,763.10	305.4	327.50	468.2	402.20	307	400.70	485.1	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-8.40	-20.60	-43.30	-48.70	-47.00	-159.60	-47.40	-24.10	-27.30	-34.20	10.10	-15.20	-6.50	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	193.30	28.70	25.80	28.30	27.80	110.60	27.20	24.60	30.30	43.90	50.80	44.90	42.70	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-49.30	-69.10	-77.00	-74.80	-270.20	-74.60	-48.70	-57.60	-78.10	-40.70	-60.10	-49.20	Income Debt
Bilanci i transfertave	702.10	145.30	175.60	198.30	205.40	724.60	180.70	210.30	176.50	201.00	169.00	216.50	209.80	Balance of Transfers
Transferta private	681.40	172.60	204.40	230.60	244.20	851.80	211.90	243.30	219.10	247.20	205.00	249.70	250.30	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	20.70	-27.30	-28.80	-32.30	-38.80	-127.20	-31.20	-33.00	-42.60	-46.20	-36.00	-33.20	-40.50	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	47.70	22.50	22.40	20.70	21.10	86.70	26.00	21.30	45.60	32.80	6.60	7.20	3.10	Capital Account
Llogaria financiare	775.60	-161.90	-184.20	-363.00	-247.20	-956.30	-279.1	-208.1	-426.6	-412.4	-114.0	-253.6	-15.8	Financial Account
Investime direkte	893.10	-168.00	-150.40	-253.50	-229.40	-801.30	-257.70	-211.30	-234.00	-120.00	-143.60	-240.10	-276.40	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	14.50	14.00	-12.40	104.70	120.80	-74.70	-66.80	-11.20	-172.10	107.50	-8.70	-2.10	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-8.40	-47.80	-97.10	-122.50	-275.80	109.20	106.10	-183.20	-120.60	-7.00	30.70	296.90	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	315.30	49.90	104.20	86.40	70.50	311.00	46.20	-38.80	167.10	121.50	54.00	93.00	132.70	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	111.90	-37.20	-30.20	156.90	-38.70	50.80	55.90	36.10	-1.80	169.30	-49.60	-0.10	-56.00	Overall Balance
						0.00								
Rezervat	-104.40	-40.30	22.50	154.00	-39.00	97.20	111.80	16.20	312.50	169.10	-49.60	0.00	-56.10	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	-3.20	52.80	-2.90	-0.30	46.40	55.90	36.10	-1.80	-0.30	70.90	35.50	34.20	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2013	2014	2015	2016	2017	Millions of Lek End of Period
					Janar January	
Mjetet valutore neto	274198.1	292,098.3	365,663.3	389,612.7	372,032.3	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	294111.3	318,940.2	407,654.7	418,562.1	401,162.8	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	19913.2	26,841.9	41,991.5	28,949.4	29,130.5	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	67841.8	82,525.1	63,394	65,915.7	58,978	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	44503.1	55,198.3	48,752	34,255.6	23,305	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	66768.8	71,831.3	75,143.9	53,279.9	53,157.7	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	22265.7	16,633.0	26,391.9	19,024.3	29,852.7	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	21502.9	25,547.8	12,237.0	29,934.4	33,947.4	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	37.3	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1835.8	1,741.7	1,648.9	1,725.7	1,725.1	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	308073.7	332,899.3	383,972.8	414,380.9	388,321.4	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	787.9	1,093.8	451.8	194.0	195.1	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	1309.8	14.8	34.2	47.2	14.0	Other accounts payable
Të tjera neto	-14102.8	-15,170.5	-18,792	-20,953.6	-21,044	Other items net
Aksione	45,971.3	55,786.1	63,391.1	61,859.9	63,523.0	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

KREDIA PËR EKONOMINË

Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2013	2014	2015	2016	2017		Million of Lek End of Period
					Janar January		
Totali i kredisë	547927.6	559,986.7	546,873	547,602.4	545,232.8		Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	256	777.7	887.7	845.5	838.3		Credits to local Government
Në lekë	256	777.7	887.7	845.5	838.3		in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-		in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	24961	27,328.1	27,419.7	26,863.9	26,880.1		Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	20251.4	22,402.3	22,326.1	23,993.9	23,745.5		in Lek
Në valutë	4709.6	4,925.8	5,093.6	2,870.0	3,134.6		in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	363541.2	372,166.5	355,725.2	343,483.0	340,254.3		Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	122944.7	129,429.4	129,233.7	131,743.5	130,970.3		in Lek
Në valutë	240596.5	242,737.1	226,491.5	211,739.5	209,284.0		in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	9578.2	8,270.3	9,537.7	8,687.6	9,113.6		Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	4238.4	3,436.9	5,036.2	4,242.3	4,136.7		in Lek
Në valute	5339.8	4,833.4	4,501.5	4,445.3	4,976.9		in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	149591.2	151,444.1	153,303.1	167,722.4	168,146.5		Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	72242.5	77,396.7	83,319.7	98,722.3	99,010.8		in Lek
Në valutë	77348.7	74,047.4	69,983.4	69,000.1	69,135.7		in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2013	2014	2015	2016	2017	Millions of LEK End of Period
					Janar January	
Baza monetare	308,073.7	332,899.3	383,972.8	414,380.9	388,321.4	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	3.5	8.1	15.3	1.1	1.0	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave depozituese	198,892.7	217,665.6	239,218.1	249,256.5	249,376.5	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	3.2	9.4	9.9	4.2	5.9	Y/Y change in %
Depozita	950,088.4	977,420	687,292.6	737,808	737,314.5	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	2.1	2.9	-29.7	7.3	8.0	Y/Y change in %
Agregati M1	295,876.5	353,321.7	384,106.9	435,432.3	430,698.1	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	5.2	19.4	8.7	13.4	14.9	Y/Y change in %
Agregati M2	693,172.2	722,356.7	723,975.7	736,944.1	729,179.3	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	3.5	4.2	0.2	1.9	2.5	Y/Y change in %
Agregati M3	1,148,980.9	1,195,086.3	1,218,101.2	1,263,453.8	126,274.0	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	2.3	4.0	1.9	3.9	4.2	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare						Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	274,198.1	292,098.3	365,663.3	389,612.7	372,032.3	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	67,841.8	82,525.1	63,394.2	65,915.7	58,977.5	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	44,503.1	55,198.3	48,752.0	34,255.6	23,305.0	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	21,502.9	25,547.8	12,987.1	29,934.4	33,947.4	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2013	2014	2015	2016	2017		Millions of Leks End of Period
					Janar January		
Në lekë	494,279.5	504,691	493,374	487,687	483,032		In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë	96,983.9	135,656	153,506	186,176	184,551		Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	1,305.0	2,047.5	1,473.8	1,907.5	1,826.2		Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,108.2	9,799.5	8,736.2	6,786.0	6,919.6		Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	937.0	1,919.8	1,258.9	2,071.0	2,235.0		Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	24,244.0	38,198.6	40,993.6	46,051.0	45,209.7		Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	64,389.7	83,690.6	101,043.0	129,360.4	128,360.4		Other resident sectors
Depozita të tjera	397,295.6	369,035	339,869	301,512	298,481		Other deposits
Qeveria lokale	57.1	7.8	29.9	18.9	18.9		Local governments
Korporata jofinanciare publike	1,257.8	1,167.9	815.0	976.8	1,027.5		Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,556.5	1,730.1	3,573.4	7,553.4	7,336.3		Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	14,523.4	11,772.0	11,292.1	6,502.2	6,702.1		Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	378,900.8	354,357.3	324,158.3	286,460.2	283,396.3		Other resident sectors
Në valutë	455,808.9	472,729	193,918	250,121	254,283		In foreign currency
Qeveria lokale	372.6	231.3	209.5	366.1	196.5		Local governments
Korporata jofinanciare publike	4,486.2	7,099.6	3,645.4	2,999.4	2,767.9		Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	6,673.1	4,872.9	2,641.2	1,815.4	2,433.7		Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	49,382.3	55,834.3	53,618.9	73,325.0	74,624.4		Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	394,894.7	404,691.2	133,803.4	171,614.8	174,260.0		Other resident sectors
Totali	950,088.4	977,420	687,293	737,808	737,315		Total
Qeveria lokale	1,735	2,286.6	1,713.2	2,292.5	2,041.6		Local governments
Korporata jofinanciare publike	11,852.2	18,067.0	13,196.6	10,762.2	10,715.0		Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	10,166.6	8,522.8	7,473.5	11,439.8	12,005.0		Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	88,149.7	105,804.9	105,904.6	125,878.2	126,536.2		Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	838,185.2	842,739.1	559,004.7	587,435.4	586,016.7		Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2013	2014	2015	2016	2017	Millions of Lek End of period
					Janar January	
AKTIVET	398,814	433,878	516,358	524,731	511,198	
Total	40,652	51,880	126,386	131,887	121,931	Total
Mbajtjet e SDR	10,508.0	19,299.7	30,578.8	27,211.8	25,003.0	SDR holdings
Arka në valutë	57.3	56.2	84.9	52.0	27.1	Foreign currency
Depozitat	30,086.2	32,524.0	95,722.4	104,622.9	96,900.5	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	308,387	320,745	323,679	315,113	307,742	Securities other than shares
Jorezident	243,178.6	256,796.7	270,453.6	261,877.5	254,698.0	nonresidents
Qeveria qendrore	65,208.4	63,947.9	53,225.5	53,235.2	53,044.0	central government
Huatë	23,333	27,286	14,641	31,660	35,672	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	21,502.3	25,547.8	12,987.1	29,934.4	33,947.4	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,830.9	1,738.5	1,654.0	1,725.9	1,725.0	Other resident sectors
Derivatet financiare	31.5	17.4	27.7	15.8	15.7	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	11,994.1	18,197.8	32,741.6	25,094.1	24,917.2	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	14,416.4	15,752.1	18,882.5	20,961.2	20,919.9	Nonfinancial assets
DETYRIMET	398,814	433,878	516,358	524,731	511,198	LIABILITIES
Total	208,042	226,588	241,006	262,031	259,938	Total
Para në qarkullim	207,792.7	226,434.1	239,218.1	258,848.0	256,854.9	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	249.7	154.2	1,787.9	3,183.2	3,082.8	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	132,765	140,569	201,586	191,380	178,188	Deposits excluded from broad money
Jorezident	9,706.5	16,564.1	31,826.2	19,860.9	19,797.8	Nonresidents
Qeveria qendrore	22,239.2	16,600.5	26,340.8	18,975.1	29,811.6	Central government
Korporata të tjera depozituese	100,031.3	106,310.9	142,966.8	152,349.7	128,383.6	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	62.5	85.0	87.4	72.1	73.3	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	725.4	1,008.8	364.4	121.9	121.9	
Huatë	2,919	2,294	1,810	314	274	-
Jorezidentët	2,919.3	2,294.2	1,809.6	314.2	273.9	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	1,828.3	886.8	461.1	1,164.6	1,256.9	Other accounts payable
Alokimi i SDR	7,287.5	7,753.2	8,104.4	7,981.2	8,018.1	SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	45,971.3	55,786.1	63,391.1	61,859.9	63,523.0	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania